VENDIM
Nr. 900, datë 12.12.2012

PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE NË FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, të shkronjës "ç" të nenit 4 të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për:

a) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 1, 1 (një) parcelë ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 134 (njëqind e tridhjetë e katër) m²;

b) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 2, 5 (pesë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 186,4 (dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë presje katër) m²;

c) Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 3, 74 (shtatëdhjetë e katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 439,55 (tre mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë presje pesëdhjetë e pesë) m²;

ç) Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës, 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 34 491 (tridhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) m²;

d) Drejtorinë e ALUIZNI-t Shkodër, 101 (njëqind e një) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 19 416,75 (nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë presje shtatëdhjetë e pesë) m²;

dh) Drejtorinë e ALUIZNI-t Lezhë, 105 (njëqind e pesë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 30 785,94 (tridhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë presje nëntëdhjetë e katër) m²;

e) Drejtorinë e ALUIZNI-t Berat, 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 17 850,39 (shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë presje tridhjetë e nëntë) m²;

ë) Drejtorinë e ALUIZNI-t Fier (1), 157 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 51 659,05 (pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë presje zero pesë) m²;

f) Drejtorinë e ALUIZNI-t Korçë, 8 (tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 467,79 (katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje shtatëdhjetë e nëntë) m²;

g) Drejtorinë e ALUIZNI-t Pogradec, 4 (katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 628,76 (gjashtëqind e njëzet e tetë presje shtatëdhjetë e gjashtë) m²;

gj) Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan 1, 47 (dyzet e shtatë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 7 475 (shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) m²;

h) Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan 2, 82 (tetëdhjetë e dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 19 839,3 (nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë presje tre) m²;

i) Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlorë 1, 122 (njëqind e njëzet e dy) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 32 669,6 (tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë presje gjashtë) m²;

j) Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlorë 2, 263 (dyqind e gjashtëdhjetë e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 89 463 (tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre) m²;

k) Drejtorinë e ALUIZNI-t Sarandë, 333 (treqind e tridhjetë e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 135 037,5 (njëqind e tridhjetë e pesë mijë e tridhjetë e shtatë presje pesë) m²;

l) Drejtorinë e ALUIZNI-t Kukës, 1 (një) parcelë ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 500 (pesëqind) m²;

ll) Drejtorinë e ALUIZNI-t Gjirokastër, 46 (dyzet e gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 11 140,9 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet presje nëntë) m²;

m) Drejtorinë e ALUIZNI-t Krujë, 11 (njëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 543 (dy mijë e pesëqind e dyzet e tre) m²;

n) Drejtorinë e ALUIZNI-t Kavajë, 12 (dymbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 6 123,9 (gjashtë mijë e njëqind e njëzet e tre presje nëntë) m²;

nj) Drejtorinë e ALUIZNI-t Lushnjë, 1 (një) parcelë ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 92,7 (nëntëdhjetë e dy presje shtatë) m².

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha